



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 587/ 2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Nehat Idrizi kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të kërcënimit dhe parregullsive gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

## **V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

## **A r s y e t i m**

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjekti politik LVV, ne te cilën pretendohet se me datë 12.12.2010, në orën 18:15, ne Drenas ne shkollën “Gjergj Kastrioti Skenderbeu”ne QV 0301X janë marrur 2 tuba me fletvotime dhe janë nxjerr jasht. Sipas parashtruesit te ankesës, në po të njejtin vend janë rrahur dy aktivist të Lëvizjes Vetëvendosje me emrin Sami Halitaj dhe Musa Miftari.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë, përveç se përmend Sami Halitaj dhe Musa Miftari, në cilësinë e dëshmitarit.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh si vijon:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku*

*mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

**- ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës janë të pabazuara për shkakun se nuk është ofruar asnjë dëshmi apo prova të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur shkelja e pretenduar nga subjekti politik PDK. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 587/2010 më datën 16.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit  
Nehat Idrizi**

